



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

## MIRËNJOHJET “MIK I FËMIJËVE”

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë – KOMF, në partneritet me Organizatën për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe KMOP, përmes projektit “Aksioni i Përbashkët për Decentralizim” financuar nga Bashkimi Evropian dhe menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe programit të Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) ‘EJA Kosovë’, bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut, ndan mirënjohjet vjetore “Mik i fëmijëve” për partnerët më të afërt të projektit, kontribues në fushën e mbrojtjes sociale dhe decentralizimit të shërbimeve sociale, me fokus mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë, për vitin 2022.

Tre mirënjohje vjetore “Mik i Fëmijëve”, do të ndahen për partnerë të projektit, individë apo subjekte të cilët kanë dhënë kontribut drejt mbrojtjes sociale, mbrojtjes së fëmijëve dhe familjeve duke qenë pjesë e përmbushjes së suksesshme të procesit të decentralizimit të shërbimeve sociale, gjatë vitit 2022.

Mirënjohjet për kontribuesit më të mëdhenj në fushën e mbrojtjes sociale gjatë vitit 2022 nuk do të jenë në vlerë monetare por në formë të mirënjohjes dhe falenderimit për kontributin e dhënë.

### Legjitimiteti

Kandidatët duhet të kenë kontribuar në fushën e mbrojtjes sociale dhe decentralizimit të shërbimeve sociale në Kosovë gjatë vitit 2022, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në fushën e mbrojtjes dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, arsimit, drejtësisë etj.

Kandidatët mund të jenë subjekte juridike sikurse korporata, biznese, banka, trupa diplomatik, medime, personalitete dhe individë nga komuniteti.

### Kriteret e përzgjedhjes

Kriteret e përzgjedhjes do të përfshijnë:

- Shtrirjen, fushëveprimin e shërbimit/veprimin/iniciativës/ndikimit/përpjekjes/ këmbënguljes;
- Cilësinë dhe/ose sasinë e ndryshimit / ndikimit në shoqëri;
- Shtrirjen e inovacionit si pjesë e ndikimit / ndryshimit;
- Pasionin e demonstruar;
- Vazhdimësinë dhe qëndrueshmërinë në ofrimin e mbështetjes.

Mbështetur nga:



Implementuar nga:



## Vlerësimi

Vlerësimi i nominimeve do të bëhet nga një panel vlerësues i jashtëm, i përbërë nga personalitete prej fushave si shoqëria civile, universiteti, komuniteti, etj.

Pas vendimit të panelit, KOMF merr vendimin final për fituesit.

- Paneli do të përbëhet nga tre personalitete, jashtë përbërjes së KOMF, për të ruajtur transparencën dhe shmangur konfliktin e interesit;
- KOMF do të dërgojë ftesa zyrtare për anëtarët e panelit vlerësues;
- Paneli bën vlerësimin e nominimeve dhe në bazë të vlerësimit, merr vendim me shkrim për fituesit e mirënjohjeve dhe jep arsyetimin e vendimit për secilin fitues.
- KOMF merr vendimin final rreth aprovimit të fituesve të shpallur nga paneli.

### Aplikantët që konkurojnë duhet t'i përmbahen këtyre kriterëve:

1. Të kenë dhënë kontribut në fushën decentralizimit të shërbimeve sociale me fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Kosovë gjatë vitit 2022, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në fushën e mbrojtjes dhe mirëqenies sociale, shëndetësisë, arsimit, drejtësisë etj;
2. Kandidatët mund të jenë subjekte juridike sikurse korporata, biznese, banka, trupa diplomatik, medime, personalitete dhe individë nga komuniteti;
3. Të plotësojnë dhe dorëzojnë formularin i cili gjendet i bashkangjitur si aneks në fund të kësaj thirrjeje. Formulari duhet të përmbajnë emrin e personit/subjektit/biznesit dhe arsyetimin përkatës të kandidaturës. Arsyetimi duhet të jetë i saktë dhe i detajuar, duke përmbajtur informacionin e nevojshëm rreth kontributit të dhënë dhe arsyeve pse kandidati është nominuar për këtë mirënjohje.
4. Kandidatët mund të nominohen nga persona të tjerë, apo të vetënominohen. Ju mund të dorëzoni një, apo më shumë nominime.

### Afatet për aplikim:

- Shpallja do të qëndrojë e hapur që nga data e shpalljes së tij në [www.portalpune.com](http://www.portalpune.com) dhe faqet zyrtare të KOMF, SOS dhe OFAP, nga data **9 Nëntor 2022 deri më 25 Nëntor 2022, ora 00:00**.
- Nominimi / formulari i plotësuar, duhet të dërgohet në [info@komfkosova.org](mailto:info@komfkosova.org) deri në datën **25 Nëntor 2022, ora 00:00**.
- Mirënjohjet për fituesit do të ndahen gjatë një ceremonie e cila do të organizohet gjatë muajit Dhjetor 2022.

KOMF, Organizata për Fëmijët pa Kujdes Prindëror – OFAP, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe inkurajojnë të gjithë partnerët dhe mbështetësit e projektit, individë apo subjekte të cilët përmes ndihmës ndaj fëmijëve kanë dhënë kontribut në përmirësimin e mbrojtjes sociale dhe decentralizimit të shërbimeve sociale, të aplikojnë për tre mirënjohjet "Mik i Fëmijëve", që do të ndahen këtë vit.

## FORMULARI PËR NOMINIM

Faleminderit për nominimin që po bëni. Ju lutemi të merrni pak minuta kohë dhe të plotësoni pyetjet e mëposhtme rreth individit/subjektit që po nominoni.

1. Emri, Mbiemri i të nominuarit (Emri i individit ose subjektit që po nominoni):

2. Pozita e saj/tij (në rast se i nominuari është individ):

3. Argumentet kryesore për nominim:

(\*Për pyetjen numër 3, përgjigjuni shkurtimisht se si janë përmbushur kriteret e mëposhtme nga individi/subjekti që po nominoni, gjatë kontributit të ofruar)

1. Ndikimi/impakti: Çfarë ndikimi ka pasur kontributi i ofruar, si ka ndikuar tek fëmijët, familjet, komuniteti.
2. Cilësia/ sasia e ndikimit në shoqëri: A ka ndikuar kontributi në shoqëri, a ka prodhuar ndryshime cilësore.
3. Qëndrueshmëria: A ka prodhuar ndryshim afatgjatë tek fëmijët, kontributi i ofruar.
4. Përfshirja e komunitetit: A ka patur përfshirje dhe angazhim të komunitetit për ndryshime më të mëdha.

Emri, Mbiemri i nominuesit: